

Tabela e Përmbajtjes- Shqipëria

Tabela e Përmbajtjes- Shqipëria	1
Si të raportoni korrupsionin dhe të siguron mbrojtje ligjore?	2
Informacion kyç mbi sinjalizimin	3
Çfarë është sinjalizimi?	3
Kush mund ta raportojë shkeljen?	3
Kush gëzon të drejtën e mbrojtjes për raportimin e shkeljeve?	3
A mund të sinjalizohet një shkelje në mënyrë anonime?	4
A është sinjalizimi konfidencial?	4
Cilat shkelje mund të raportohen?	4
A janë të nevojshme provat, apo mjafton dyshimi në mirëbesim si kusht për të pranuar në sinjalizim?	4
A vihet në gjyq motivimi i sinjalizuesve përse i përket mirëbesimit?	5
Çfarë lloj mbrojtje parashikon ligji për sinjalizuesit?	5
Çfarë përbën abuzim me sinjalizimin dhe cilat janë pasojat?	6
A janë sinjalizuesit imunë ndaj përgjegjësive disiplinore, civile apo penale në lidhje me raportimin e shkeljeve?	6
Procedurat e sinjalizimit	7
Si mund të sinjalizohet një shkelje?	7
Cila është procedura e sinjalizimit të brendshëm?	7
Cila është procedura pas sinjalizimit të brendshëm?	8
Cila është procedura e sinjalizimit të jashtëm?	9
Cila është procedura pas sinjalizimit të jashtëm?	9
Mbrojtja kundër hakmarrjes e sinjalizuesve	11
Kundër çfarë forme të hakmarrjes gëzon mbrojtje sinjalizuesi?	11
Cilat janë kushtet për mbrojtjen kundër hakmarrjes?	11
Nga kush mund të kërkohet mbrojtja?	11
Mbështetje ligjore për sinjalizuesit	13
Çfarë mbështetje ligjore është në dispozicion për sinjalizuesit?	13
Çfarë materiale informuese mbi sistemin e sinjalizimit janë në dispozicion?	14
Informacione dhe burime të mëtejshme	15

Si të raportoni korrupsionin dhe të siguroni mbrojtje ligjore?

Ky material synon t'i ofrojë publikut informacion mbi mundësitë e raportimit të mbrojtur të korrupsionit në Shqipëri. Këtu mund të gjeni se çfarë do të thotë raportim i mbrojtur, kush mund ta raportojë korrupsionin, dhe cilat shkelje mund të raportohen. Gjithashtu, ju mund të gjeni informacion se si t'i raportoni shkeljet dhe kujt t'i raportoni. Materiali më poshtë ofron informacion mbi mundësinë e mbrojtjes, ndaj veprimeve të dëmshme që mund të ndërmerren për të penguar raportimin e shkeljes, ose hakmarrjen si rezultat i raportimit.

Bazuar në materialin më poshtë, ju mund të vlerësoni informacionin tek i cili keni qasje, që mund të tregojë korrupsion, dhe të vendosni nëse ky informacion siguron baza për raportim të mbrojtur të korrupsionit, dhe cilat janë pasojat e mundshme të raportimit të korrupsionit dhe abuzimi me raportimin e korrupsionit.

Ky material është përgatitur mbështetur në legjislacionin në fuqi, kryesisht mbi Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Informacioni i dhënë nuk është këshillë ligjore, dhe për rrjedhojë rekomandohet konsultimi në detaje i legjislacionit, dhe adresimi i autoriteteve kompetente për udhëzime specifike. Materiali ofron informacion mbi insitucionet përkatëse të cilat ofrojnë ndihmë juridike për sinjalizuesit.

Informacion kyç mbi sinjalizimin

Çfarë është sinjalizimi?

Sipas ligjit Nr. 60/2016 për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve (në vijim: ligji), çdo person i cili vihet në dijeni për një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, të kryer në vendin e tij të punës, ka të drejtë të sinjalizojë mbi këtë fakt.

Sinjalizimi është raportimi i informacionit tek njësi përgjegjëse e autoritetit publik ose subjektit privat ku sinjalizuesi punon, ose tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILKKPKI), në lidhje me veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij/saj të punës, në autoritetin publik apo subjektin privat.

Kush mund ta raportojë shkeljen?

Sipas ligjit, sinjalizues është individ i cili ka hyrë në një marrëdhënie pune, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës dhe kohëzgjatja, e paguar ose jo, i cili raporton ose sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

Punonjësit në sektorin publik dhe privat mund t'i fryjnë bilbilit. Kjo përfshin punonjësit pa pagesë, aplikantët, si dhe ish të punësuarit në sektorin publik ose privat. Megjithatë, ligji shprehet që është i zbatueshëm për të gjithë individët pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës, nuk shprehet nëse aplikohet për kontraktorët, kursantët, ose anëtarët e trupave drejtuese.

Ligji zbatohet tek autoritetet publike dhe subjektet private. Ligji e përkufizon "autoritetin publik" në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Informimit. Prandaj, autoriteti publik përfshin organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë, organet e njësive të qeverisjes vendore, si dhe ente të tjera publike të përcaktuara nga ligji.

Sipas ligjit, "subjekt privat", është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

Kush gëzon të drejtën e mbrojtjes për raportimin e shkeljeve?

Sinjalizimi është i mbrojtur nëse shkelja raportohet në përputhje me procedurën e parashikuar. Për të gëzuar të drejtën për mbrojtje, punonjësit në autoritetet publike ose subjektet private duhet ta sinjalizojnë një shkelje në përputhje me dispozitat e këtij ligji, para individëve dhe institucioneve të paracaktuara nga ligji.

Ligji nuk mbron qartësisht personat të cilët e ndihmojnë sinjalizuesin për të raportuar, as ata të cilët perceptohen se do t'i fryjnë bilbilit ose ata të cilët gabimisht perceptohen se i kanë fryrë bilbilit.

A mund të sinjalizohet një shkelje në mënyrë anonime?

Ligji e njuh të drejtën e sinjalizimit anonim, në rrethana legjitime për veprime ose praktika të dyshuara korrupsioni. Sinjalizimi anonim pranohet, nëse në të janë arsyetuar shkaqet e anonimatit dhe të dhënat e sinjalizimit sigurojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Kjo nënkupton që personi duhet të shpjegojë arsyet e anonimatit, dhe që njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja mund ta refuzojnë hetimin administrativ të sinjalizimit nëse personi nuk ka arsye ligjore për të mbetur anonim.

A është sinjalizimi konfidencial?

Konfidencialiteti i informacionit identifikues të sinjalizuesit është i garantuar me ligj. Ligji kërkon që njësi përgjegjëse në autoritetet publike ose subjektet private, ose ILDKPKI-ja, të ruajnë konfidencialitetin e identitetit dhe burimit të informacionit të sinjalizuesit gjatë hetimit administrativ. Informacion i nevojshëm mund t'u komunikohet vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ, dhe çdo person i cili merr informacion konfidencial, ka të njëjtin detyrim të ruajtjes së konfidencialitetit.

Identiteti i sinjalizuesit nuk mund t'u bëhet i ditur personave të tretë pa pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit, ose kjo mund të bëhet vetëm në përmbushje të një detyrimi ligjor. Personi i ngarkuar me marrjen e informacionit konfidencial gjatë hetimit administrativ duhet ta përpunojë informacionin në mënyrë konfidenciale.

Në rast të shkeljes së detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit ose të dhënave personale të sinjalizuesit, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (<https://www.idp.al/>). Në përputhje me ligjin, shkelja e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit, dënohet me gjobë nga 150 000 deri në 300 000 lekë.

Cilat shkelje mund të raportohen?

Ligji e kufizon mundësinë e sinjalizimit për shkeljet e lidhura me korrupsionin në vendin e punës, qoftë në sektorin publik ose atë privat. Ligji përmend si vepra penale të raportueshme të korrupsionit çdo veprim ose mosveprim të kundraligjshëm, në lidhje me çdo formë të korrupsionit aktiv, korrupsionit pasiv, përfshirë edhe korrupsionin aktiv/pasiv në zgjedhje, shpërdorimin e detyrës ose kompetencave, ushtrimin e ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave ose marrjen e vendimeve, shpërdorimin e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, përfitimin e paligjshëm të interesave, rryshfetin, si dhe çdo akt tjetër të ngjashëm me të mësipërmit.

A janë të nevojshme provat, apo mjafton dyshimi në mirëbesim si kusht për të pranuar në sinjalizim?

Raportimi do të bëhet me shkrim dhe do të përmbajë, ndër të tjera përshkrimin e fakteve dhe rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprim ose praktikë të dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur.

Një person i cili synon të sinjalizojë një veprim ose praktikë të dyshuar të korrupsionit duhet të ketë shkaqe të arsyeshme për ta ndërmarrë këtë akt. Kjo do të thotë që sinjalizuesi duhet të jetë i sigurt që ka ndodhur ose pritet të ndodhë një shkelje. Pra, vetëm dyshimi nuk mjafton.

Sinjalizuesit i ofrohet mbrojtja për sinjalizimin e kryer në kushtet e mirëbesimit, të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni sipas ligjit. Sinjalizuesi konsiderohet se ka vepruar në mirëbesim, nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar së është duke sinjalizuar një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, si dhe:

- a) nuk e dinte ose nuk kishte mundësi objektive për të ditur se informacioni i sinjalizuar nuk ishte i vërtetë ose i saktë;
- b) sinjalizimi nuk kryhet në mënyrë abuzive, shpifëse ose mashtruese.

Sinjalizuesi prezumohet të jetë në mirëbesim, derisa nuk provohet e kundërta nga njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja

Njësia përgjegjëse në autoritetin publik ose subjektin privat, ose ILDKPKI-ja ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrative nëse:

- sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga ligji, dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
- sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana të tjera nga një veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni;
- nëse ka prova të mjaftueshme të kundërvajtjes administrative ose të një vepre penale.

[A vihet në gjyq motivimi i sinjalizuesve përsa i përket mirëbesimit?](#)

Është e nevojshme që sinjalizimi të bëhet në kushtet e mirëbesimit, siç rregullohet me ligj. Në këtë pikëpamje, pakënaqësia personale nuk përbën shkak për sinjalizim.

Sipas ligjit, sinjalizuesit i ofrohet mbështetje nëse sinjalizimi është kryer në kushtet e mirëbesimit, derisa nuk provohet e kundërta. Ligji konsideron se sinjalizuesi ka vepruar në mirëbesim kur sinjalizimi nuk kryhet në mënyrë abuzive, shpifëse ose sinjalizuesi nuk mashtron mbi informacionin e sinjalizuar. Kjo nënkupton që motivimi i sinjalizuesit do të vihet në gjyq.

Sinjalizuesi nuk e humbet të drejtën e mbrojtjes nëse nuk e dinte ose nuk kishte mundësi objektive për të ditur se informacioni i sinjalizuar nuk ishte i vërtetë ose i saktë, ose në rast se nga hetimi rezulton se nuk është kryer një vepër penale e korrupsionit. Sinjalizuesi prezumohet të jetë në mirëbesim, derisa nuk provohet e kundërta.

[Çfarë lloj mbrojtje parashikon ligji për sinjalizuesit?](#)

Mbrojtja i ofrohet kujtdo i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, në përputhje me dispozitat e ligjit. Njësia përgjegjëse në autoritetin publik ose subjektin privat

është e detyruar të ofrojë mbrojtje administrative dhe të marrë masa të menjëhershme për riparimin e pasojave të hakmarrjes.

Në rast se njësia përgjegjëse nuk merr menjëherë masat, kërkesa për mbrojtje paraqitet tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI, <https://www.ildkpk.al/>). Nëse në përfundim të hetimit administrativ të realizuar nga ILDKPKI-ja, rezulton se është kryer një akt hakmarrje ndaj sinjalizuesit, ILDKPKI-ja urdhëron autoritetin publik apo subjektin privat për marrjen e të gjitha masave për riparimin e shkeljes së kryer.

Në rast të mos riparimit të shkeljeve të kryera, sinjalizuesi mund t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar shpërblim për dëmin e pësuar nga akti i hakmarrjes.

Çfarë përbën abuzim me sinjalizimin dhe cilat janë pasojat?

Ligji nuk e adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë se çfarë përbën abuzim me sinjalizimin dhe pasojat e tij. Sinjalizuesi duhet të veprojë në kushtet e mirëbesimit. Sinjalizimi nuk kryhet në mënyrë abuzive, shpifëse ose sinjalizuesi nuk mashtron mbi informacionin e sinjalizuar. Njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ, nëse sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të ligjit.

A janë sinjalizuesit imunë ndaj përgjegjësive disiplinore, civile apo penale në lidhje me raportimin e shkeljeve?

Sinjalizuesi, i cili raporton një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, në përputhje me dispozitat ligjore, mbrohet ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë ndaj tij/saj nga organizata.

Mbrojtja përfshin, por pa u kufizuar në, shkarkimin nga puna, pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave, transferimin, uljen në detyrë, uljen e pagës, humbjen e statusit dhe të privilegjeve, mosngritjen në detyrë dhe heqjen e të drejtës për të marrë pjesë në trajnime, vlerësim negativ të performancës. Ligji nuk parashikon imunitet të sinjalizuesve ndaj përgjegjësive disiplinore, civile apo penale në lidhje me sinjalizimin e shkeljeve.

Procedurat e sinjalizimit

Si mund të sinjalizohet një shkelje?

Ligji parashikon sinjalizimin e brendshëm dhe atë të jashtëm. Sinjalizimi i brendshëm është raportimi i kryer brenda njësisë përgjegjëse të autoritetit publik ose subjektit privat.

Sinjalizimi i jashtëm është raportimi i kryer pranë ILDKPKI-së. Sinjalizuesi inkurajohet të raportojë fillimisht brenda njësisë përgjegjëse, megjithatë raportimi mund të kryhet direkt pranë ILDKPKI-së gjithashtu.

Sipas ligjit, në rast se sinjalizuesi, njofton publikisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, ai/ajo humbet të drejtën e mbrojtjes nga hakmarrja.

Cila është procedura e sinjalizimit të brendshëm?

Sinjalizuesi mund të raportojë veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar, ose të deklarohet verbalisht para njësisë përgjegjëse të autoritetit publik ose subjektit privat. Kjo presupozon edhe komunikimin elektronik. Megjithatë, që sinjalizimi të quhet i vlefshëm, nevojitet që sinjalizuesi të kontaktojë fizikisht punonjësit e njësisë përgjegjëse dhe që sinjalizimi të dokumentohet me shkrim prej tyre.

ILDKPKI-ja ka hartuar dhe publikuar formular të sinjalizimit të brendshëm, të cilat mund të gjenden në: <https://www.ildkpi.al/formulare/>.

Sinjalizimi bëhet me shkrim dhe përmban të paktën:

- të dhënat e identitetit dhe të kontaktit të sinjalizuesit;
- përshkrimin e fakteve dhe rrethanave për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;
- referimin përkatës në Kodin Penal, për aq sa është e mundur;
- shkaqet ligjore në rast të përdorimit të mekanizmit të raportimit të jashtëm.

Ligji kërkon që pranë çdo autoriteti publik, i cili ka më shumë se 80 të punësuar, të caktohet një njësi përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet. Ligji kërkon që pranë çdo subjekti privat, i cili ka më shumë se 100 të punësuar, të caktohet një njësi përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet.

Të gjitha autoritetet publike dhe subjektet private, janë të detyruara të hartojnë dhe miratojnë rregulloret e tyre të brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjes nga hakmarrja. Çdo autoritet publik është i detyruar t'i publikojë këto rregullore në faqen zyrtare në web.

Në përputhje me strukturën e organizatës, njësi përgjegjëse mund të përbëhet nga një ose më shumë persona të trajnuar. Punonjësit brenda njësisë përgjegjëse janë të trajnuar posaçërisht për mekanizmat e sinjalizimit dhe në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve, në

përputhje me udhëzimet e Këshillit të Ministrave, për autoritetet publike dhe ILDKPKI-së për sektorin privat.

Gjatë hetimit administrative, njësia përgjegjëse duhet të shmang çdo konflikt interesi dhe të deklarojë menjëherë brenda organizatës konfliktin e interesit përpara fillimit të hetimit administrative të një sinjalizimi në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

Cila është procedura pas sinjalizimit të brendshëm?

Njësia përgjegjëse është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit. Njësia përgjegjëse është e detyruar të regjistrojë, hetojë administrativisht dhe shqyrtojë sinjalizimet sipas dispozitave ligjore.

Njësia përgjegjëse heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, për atë që nuk parashikohet ndryshe. Procedura e hetimit administrativ duhet të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nevojitet më shumë kohë.

Gjatë hetimit administrativ, njësia përgjegjëse mund të kërkojë informacion shtesë, urdhërojë inspektime, mbledhë deklarata ose të konsultojë ekspertë. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ mund të konsultohet me dosjen, të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione, dhe ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij/saj.

Njësia përgjegjëse njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. Njësia përgjegjëse është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi mbi çështjen e sinjalizuar prej tij/saj.

Pas përfundimit të hetimit administrativ, nëse gjenden shkelje administrative, sipas ligjit, njësia përgjegjëse vë në dijeni organin kompetent dhe merr masa të menjëhershme, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.

Nëse gjatë hetimit administrativ, rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është e bazuar, njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja, njofton menjëherë prokurorinë ose Policinë e Shtetit.

ILDKPKI-ja ka hartuar "Regjistrin e Sinjalizimit të Brendshëm në Njësinë Përgjegjëse në Organizatë". Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokollit dhe elektronik. Për më tepër, njësia përgjegjëse duhet të raportojë mbi hetimin administrativ të sinjalizimeve para ILDKPKI-së, çdo vit, jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës.

Njësia përgjegjëse ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse:

- sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar, dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit;

- sinjalizimi përmban informacione të cilat nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit (korrupsion);
- kur nuk ka elementë të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.

Cila është procedura e sinjalizimit të jashtëm?

Sipas ligjit, sinjalizimi i jashtëm është raportimi i kryer nga sinjalizuesi pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI, <https://www.ildkpkj.al/>). ILDKPKI-ja ka hartuar dhe publikuar një formular të sinjalizimit të jashtëm, i cili gjendet në: <https://www.ildkpkj.al/formulare/>.

Sinjalizimi bëhet me shkrim, forma dhe përmbajtja janë të ngjashëm me sinjalizimin e brendshëm. Përveç kësaj, në rastin e sinjalizimit të jashtëm, raportimi duhet të përmbajë shkaqet ligjore dhe rrethanat e faktit, për përdorimin e mekanizmit të sinjalizimit të jashtëm.

Sinjalizimi i jashtëm tek ILDKPKI-ja mund të kryhet në rastet kur:

- autoriteti publik ose subjekti privat nuk kanë njësi përgjegjëse për këtë qëllim;
- njësia përgjegjëse në autoritetin publik ose subjektin privat nuk fillon hetimin administrativ ose përfundon hetimin në kundërshtim me ligjin;
- ekziston dyshimi i arsyeshëm se persona brenda njësisë përgjegjëse janë përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, në veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit;
- ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e njësisë përgjegjëse;
- prova e sinjalizuesit mund të fshihet ose të shkatërrohet nga organizata.

Cila është procedura pas sinjalizimit të jashtëm?

Gjatë kryerjes së një hetimi administrativ ILDKPKI-ja duhet:

- të veprojë me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, dhe e pavarur nga pikëpamja politike;
- të shmang çdo konflikt interesi dhe të marrë masat e përshtatshme për të mbrojtur provat nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
- të ruajë konfidencialitetin dhe të mbrojë të dhënat në përmbajtje të çdo raporti sinjalizimi.

Sipas ligjit, gjatë hetimit administrativ, ILDKPKI-ja duhet të shmang çdo konflikt interesi dhe të deklarojë menjëherë tek ILDKPKI-ja konfliktin e interesit përpara fillimit të hetimit administrative të një sinjalizimi në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

ILDKPKI-ja heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, për atë që nuk parashikohet ndryshe. Procedura e hetimit administrativ duhet të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveçse kur nevojitet më shumë kohë.

Gjatë hetimit administrative, ILDKPKI-ja mund të kërkojë informacion shtesë, urdhërojë inspektime, mbledhë deklarata ose të konsultojë ekspertë. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ mund të konsultohet me dosjen, të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinionet, dhe ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij/saj.

ILDKPKI-ja njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit. ILDKPKI-ja është e detyruar t'i përgjigjet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi mbi çështjen e sinjalizuar prej tij/saj.

Pas përfundimit të hetimit administrativ, nëse gjenden shkelje administrative, sipas ligjit, ILDKPKI-ja vë në dijeni organin kompetent dhe merr masa të menjëhershme, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar. Nëse gjatë hetimit administrativ, rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është e bazuar, njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja, njofton menjëherë prokurorinë ose Policinë e Shtetit.

Në përputhje me ligjin, ILDKPKI-ja ka hartuar "Regjistrin e Sinjalizimit të Jashtëm në ILDKPKI". Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik.

ILDKPKI-ja ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ nëse:

- sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar, dhe sinjalizuesi nuk korigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit;
- sinjalizimi përmban informacione të cilat nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit (korrupsion);
- kur nuk ka elementë të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.

Mosfillimi i hetimit ose përfundimi i hetimit administrativ nga punonjësi, në kundërshtim me dispozitat e ligjit, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

Mbrojtja kundër hakmarrjes e sinjalizuesve

Kundër çfarë forme të hakmarrjes gëzon mbrojtje sinjalizuesi?

Ligji mbron sinjalizuesin ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë ndaj tij nga autoriteti publik apo subjekti privat, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- shkarkimin nga puna;
- pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
- transferim brenda ose jashtë organizatës;
- ulje në detyrë;
- uljen e pagës dhe/ose humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
- mosngritjen në detyrë dhe/ose heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
- forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.

Çdo veprim hakmarrje ndaj sinjalizuesit, të marrë nga autoriteti publik apo subjekti privat, në shkelje të dispozitave të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 300 000 deri në 500 000 lekë.

Cilat janë kushtet për mbrojtjen kundër hakmarrjes?

Mbrojtja mund t'i ofrohet kujtdo që raporton një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, sipas kriterëve të parashikuara në ligj. Sinjalizuesit i ofrohet mbrojtja për sinjalizimin e kryer në kushtet e mirëbesimit. Sinjalizuesi konsiderohet se ka vepruar në mirëbesim, nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se informacioni i raportuar është i vërtetë ose i saktë.

Nga kush mund të kërkohet mbrojtja?

Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrje, paraqet kërkesë për mbrojtje te njësia përgjegjëse në autoritetin publik apo subjektin privat. Njësia përgjegjëse është e detyruar të sigurojë mbrojtje administrative dhe të marrë masa të menjëhershme për të riparuar shkeljen e kryer. ILDKPKI-ja ka hartuar dhe publikuar "Formular Kërkesë për Mbrojtje nga Hakmarrja", i zbatueshëm si për sinjalizimin e brendshëm dhe atë të jashtëm. Formulari mund të gjendet në: <https://www.ildkpk.al/formulare/>.

Në rast se njësia përgjegjëse nuk merr menjëherë masat, kërkesa për mbrojtje paraqitet tek ILDKPKI-ja (<https://www.ildkpk.al/>). Nëse në përfundim të hetimit administrativ të realizuar nga ILDKPKI-ja, rezulton se është kryer një akt hakmarrje ndaj sinjalizuesit, ILDKPKI-ja urdhëron autoritetin publik apo subjektin privat për marrjen e të gjitha masave për riparimin e shkeljes së kryer.

Në rast të mos riparimit të shkeljeve të kryera, sinjalizuesi mund t'i drejtohet gjykatës për të kërkuar shpërbtim për dëmin e pësuar nga akti i hakmarrjes.

Njësia përgjegjëse në autoritetin publik ose subjektin privat është e detyruar të marr menjëherë masat dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje.

Në rast të shkeljes së këtij afati, kërkesa për mbrojtje paraqitet tek ILDKPKI-ja, që është e detyruar të vendosë brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës.

ILDKPKI-ja, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, njofton me shkrim sinjalizuesin për regjistrimin e pretendimit dhe emrin e personit pranë ILDKPKI-së, i cili do të ndjekë çështjen.

ILDKPKI-ja njofton sinjalizuesin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për statusin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë. Procedura e hetimit administrative të kërkesës për mbrojtje përfundon sa më shpejtë të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Nëse sinjalizuesi paraqet një kërkesë për mbrojtje kundër hakmarrjes tek ILDKPKI-ja, autoriteti publik ose subjekti privat, duhet të provojë që masat e marra në dëm të sinjalizuesit nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me sinjalizimin.

Mbështetje ligjore për sinjalizuesit

Çfarë mbështetje ligjore është në dispozicion për sinjalizuesit?

ILDKPKI ofron këshillim dhe mbështetje në lidhje me zbatimin e ligjit gjatë të gjithë fazave të procedurës së sinjalizimit. Nuk ka mbështetje tjetër ligjore të rregulluar me ligj.

Ligji Nr.111/2017 për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti, përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe interesave të ligjshëm të tij. “Ndhimë juridike” është shërbimi juridik falas dhe shërbimet e tjera të parashikuara në ligj, për personat që përmbushin kriteret e këtij ligji, të cilat garantohen dhe financohen nga shteti.

Ndhimë juridike ju ofrohet shtetasve me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme si dhe kategorive vulnerabel, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre si më poshtë:

- a) viktimave të dhunës në familje;
- b) viktimave të abuzimit seksual dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore;
- c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin;
- d) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- e) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- f) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësi të kufizuar;
- g) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm dhe trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor;
- h) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar;
- i) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- j) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- k) personave, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji nuk përcakton nëse sinjalizuesi kualifikohet për ndihmë ligjore. Nëse një person, i cili sinjalizon mbi një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme ose i përket ndonjëris prej kategorive të veçanta të përmendura më sipër, i ofrohet ndihmë juridike falas.

Ndihma juridike ofrohet nga punonjës me trajnim të posaçëm, organizata jofitimprurëse dhe nga klinikat ligjore të ngritura pranë institucioneve të arsimit të lartë. Informacion të mëtejshëm mund të gjeni në faqen zyrtare Web të Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas (<https://ndihmajuridike.gov.al/>) si dhe në faqen zyrtare Web të Ministrisë së Drejtësisë (<https://www.drejtesia.gov.al/ndihma-juridike-falas/>).

Çfarë materiale informuese mbi sistemin e sinjalizimit janë në dispozicion?

Partnerët Shqipëri, një organizatë jofitimprurëse shqiptare e pavarur, gjatë vitit 2016, organizoi një fushatë të gjerë mediatike për informimin e publikut, që konsistoi në spote informuese që u transmetuan në median kryesore kombëtare, në platformat online dhe në median sociale, si dhe reklama vizuale në tabelat e qytetit, për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë dhe mbi të gjitha të kuptuarit e vetë ligjit dhe masave të tij në luftën kundër korrupsionit. Informacionin e gjeni në:

<https://partnersalbania.org/News/zbatimi-ligjit-per-sinjalizimin-dhe-mbrojtjen-e-sinjalizuesve/>.

Informacione dhe burime të mëtejshme

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, “Udhërrëfyes për Sinjalizimin dhe Sinjalizuesit në Shqipëri”, përgatitur nga Arjan Dyrmishi për Koalicionin e Europës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve me mbështetjen e National Endowment for Democracy, gjendet në: <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2017/08/A-Guide-to-Whistleblowing-in-Albania-Eng.pdf>

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, “Udhërrëfyes për Sinjalizimin dhe Sinjalizuesit në Sektorin e Sigurisë në Shqipëri, 101 Pyetje dhe Përgjigje mbi Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve në Sektorin e Sigurisë në Shqipëri”, përgatitur nga Arjan Dyrmishi dhe Mirsada Hallunaj, gjendet në: <http://csdgalbania.org/wp-content/uploads/2019/10/udherrefyesh02.pdf>

Raportet Vjetore të ILDKPKI mund të gjenden në: <https://www.parlament.al/Kerkese?tipId=3>.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport Monitorimi, “Sinjalizimi i Korrupsionit në Shqipëri: Sfidat e Zbatimit të Kuadrit të Ri Ligjor”, përgatitur nga Rovena Vuksani, gjendet në: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/03/Raport-Monitorimi_Sinjalizimi-i-korrupsionit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri_Sfidat-e-zbatimit-t%C3%AB-kuadrit-t%C3%AB-ri-ligjor.pdf

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes, “Raportimi mbi Sinjalizimin në Mediat Shqiptare, Për një rol më të angazhuar të gazetarëve në përmirësimin e raportit mbi Sinjalizimin”, përgatiti Ben Andoni, gjendet në: <http://csdgalbania.org/sq/wp-content/uploads/2020/04/Raportimi-mbi-Sinjalizimin-ne%CC%88-Mediat-Shqiptare.pdf>